



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
DREJTORIA E TARIFAVE DHE ÇMIMEVE**

Nr. 93/17 Prot

Tiranë, më 21.12.2018

**Relacion**

**Mbi percaktimin e tarifës per aktivitetin e transmetimit të energjisë elektrike nga OST sh.a. për vitin 2019**

Me shkresën Nr. 6879 Prot dt. 4 Tetor 2018 (protokolluar në ERE me Nr. 634 Prot dt. 5 Tetor 2018), OST sh.a, ka përgatitur llogaritjen e tarifës së transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2019“, sipas materialit që Shoqëria i ka bashkangjitur kësaj shkrese.

Bordi e ERE-s, me Vendimin Nr. 224, Datë 26.10.2018 vendosi mbi fillimin e procedurave për miratimin e tarifës së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2019.

Mbas vendimmarrjes se fillimit te procedures, aplikimi per tarife u publikua ne faqen zyrtare te ERE-s dhe me tej iu dergua paleve te interesuara me ane te shkreses Nr. 634/1, date 26.11.2018.

Më tej ERE, me anë të shkresës 654/1 date 31.10.2018, pas analizës së kryer këtij aplikimi I kërkoi informacion shtesë OST sh.a. në mënyrë që kompania të argumentonte më gjërë këtë aplikim dhe që ERE të ishte sa më e drejtë në llogaritjen e kostove që I përkasin OST sh.a në ushtimin e aktivitetit të transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2019.

OST sh.a. i u përgjigj kërkesave për informacion të ERE-s me anë të shkresës nr.7531/1, Prot., datë 15.11.2018, informacione te cilat u publikuan ne faqen zyrtare te ERE-s.

Autoritetit te Konkurrences me ane te shkreses nr. 646/1, date 13.12.2018, i kerkoi ERE-s venien ne dispozicion te informacioneve plotesuese ne lidhje me aplikimin per tarifen e transmetimit per vitin 2019. Informacionet shtese te derguara nga OST sh.a. i u percollen Autoritetit te Konkurrences me ane te emailit te dates 17.12.2018.

Pas analizës së përgjigjeve të OST sh.a u zhvillua nje monitorim ne OST sh.a. ne lidhje me OPEX-in e relizuar per vitin 2017 dhe 2018 sipas urdherit te Kryetarit nr. 75, date 6.12.2018 dhe me tej u zhvillua një seancë dëgjimore në datë 19.12.2018 me përfaqësuesit e OST sh.a., OSHEE sh.a., MIE dhe Autoritetin e Konkurrencës për të diskutuar mbi këtë aplikim.

Ne perfundim te seances degjimore u ra dakord me Shoqerine, që të dergoheshin në ERE sqarime të mëtejshme për paqartësitë në lidhje me analizën e kryer të aplikimit si dhe të përgjigjeve të dërguara nga OST sh.a. në vijim të korrespondencës së lartpërmendur.

Në llogaritjen e tarifës së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2019, OST sh.a ka llogaritur kostot totale që ajo do të përballojë gjatë gjithë vitit 2019 dhe respektivisht kostot e kapitalit, kostot operative të paraqitur në 3 skenare të ndryshme të mundshme, para nga këndvështrimi I Shoqërisë, në varesi të supozimeve për pranimin e komponenteve të ndryshme që për rrjedhojë rezultojnë në nivele të ndryshme të tarifës mesatare të shërbimit të transmetimit për vitin 2019 duke e lënë në gjykimin e ERE-s pranimin e njërit ose tjetrit komponent apo skenar.

Aplikimi përbëhet nga rreth 9 (nëntë) kapituj të cilët janë përgatitur në formë të përmbledhur në vijim:

**Në kapitullin e parë**, paraqitet një informacion i përgjithshëm rreth OST sh.a ku listohen në mënyrë të detajuar përgjegjësitë kryesore të OST sh.a që burojnë nga aktet ligjore, nënligjore dhe ato rregullatore në fuqi, të tilla si operimi, mirëmbajtja dhe zhvillimi i rrjetit të transmetimit duke përfshirë interkoneksionet me vendet e tjera kufitare.

**Në kapitullin e dytë** të aplikimit flitet për nivelin e synuar të të ardhurave që kërkohen prej tarifës së transmetimit, e cila synon të mbledhë të ardhurat për të zhvilluar investimet e nevojshme në sistem, për të përballuar kostot operative të drejtimit të Shoqërisë si dhe për të minimizuar humbjet në sistemin e transmetimit.

Si rrjedhojë, tarifa e transmetimit synon të shlyejë kostot e aktiviteteve të mëposhtme:

- a) Pronësinë, ndërtimin, operimin dhe mirëmbajtjen e linjave, kabllave, nënstacioneve të transformatorëve, qendrave dispeçer dhe ndërtesave që lidhen me to si dhe facilitetet e komunikimit.
- b) Kostot e rezervave operuese të OST-së që nevojiten për të siguruar qëndrueshmërinë dhe sigurinë e sistemit të transmetimit.
- c) Kostot e shërbimeve të tjera ndihmëse të OST-së, përfshirë pagesat e bëra OST-ve fqinje për të siguruar energji elektrike emergjente dhe rezerva të çastit dhe pagesat (nëse ka) për frekuencën dhe rregullimin e tensionit.
- d) Kostot e kompensimit të energjisë reaktive, që duhen alokuar në një pagesë për energjinë reaktive
- e) Kostot për të siguruar zyra, komunikim dhe facilitete të teknologjisë së informacionit (IT) për operatorin e tregut plus kostot e personelit që lidhen me Operatorin e Tregut.

Nga këndvështrimi kontabël operatorin e tregut duhet të ketë llogaritë e tij, sikur të ishte një njësi ligjore e pavarur me të ardhura të tatsueshme më vete.

**Kapitulli i tretë** i aplikimit flet për pritshmëritë e situatës energjitike për vitin 2018. Sipas këtij parashikimi, energjia që pritet të lëvrohet në rrjetin e OST sh.a për vitin 2018 është 9,852 GWh ndërsa ajo e planifikuar për vitin 2019 është 7,337 GWh. Këtu OST sh.a bazohet në të dhënat historike si dhe duke konsideruar rritjen e mundshme të numrit dhe volumit të Konsumatorëve të Kualifikuar si dhe sasinë e energjisë së nevojshme për mbulimin e humbjeve në sistemin e transmetimit.

		Njesia e matjes	Realizimi 2015	Realizimi 2016	Realizimi 2017	Pritshmeria 2018
I.	<b>Energjia Totale qe hyn ne sistemin e OST sh.a.</b>	<b>GWh</b>	<b>7,830</b>	<b>8,250</b>	<b>7,577</b>	<b>10,100</b>
a)	Prodhimi vendas	GWh	5,475	6,000	4,174	8,056
b)	Energji ne marrje	GWh	2,355	2,250	3,403	2,044
II	<b>Energjia totale e transmetuar</b>	<b>GWh</b>	<b>7,672</b>	<b>8,080</b>	<b>7,418</b>	<b>9,852</b>
a)	Energjia elektrike e dhene	GWh	956	1,500	488	2,771
b)	Energjia elektrike per OSHEE	GWh	6,106	5,980	6,149	6,114
c)	Energjia elektrike per konsumatoret e kualifikuar	GWh	610	600	781	967
III	<b>Humbjet ne rrjetin e transmetimi t + NV</b>					-
a)	Humbjet ne GWh	GWh	159	170	159	248
b)	Humbjet ne %	%	2.03%	2.06%	2.10%	2.46%

OST sqaron se viti 2018 filloi me nje kuote rreth 290 metra ne liqenin e Fierzes, nje kuote afër nivelit maksimal të lejuar dhe mjaft të favorshme për ruajtjen e një niveli normal të sigurisë së furnizimit. Prurjet mesatare mujore të lumit Drin në liqenin e Fierzës, për gjashtë mujorin e pare të vitit ishin dy deri në tre herë me të mëdha se prurjet llogaritëse me 75% siguri. Si rrjedhoje, u rrit ndjeshëm gjenerimi i vendit si nga ana e KESH ashtu edhe nga te gjitha PPE-te, duke bërë që importi i planifikuar nga ana e OSHEE te reduktohet afër zeros (me perjashtim te kontrates me bazë vjetore), dhe nga ana tjetër është kaluar në eksportin e energjisë duke realizuar sasi te konsiderueshme, gjë e cila u shoqërua me rritjen e ndjeshme te humbjeve ne rrjetin e transmetimit.

Bazuar në të dhënat e deritanishme dhe në parashikimin për muajt e ardhshëm, pritet që për vitin 2018 gjenerimi i energjisë elektrike në vend të jetë rreth 8 mijë GWh, prej të cilave 7 mijë GWh është konsumi vendas, 248 GWh janë humbjet në sistemin e transmetimit ndërsa pjesa tjetër prej 727 GWh janë për eksport.

**Në kapitullin e katërt** të aplikimit, OST sh.a bën parashikimin e kërkesës për energji për vitin 2019 si dhe mënyrën e mbulimit të saj. Në bazë të të dhënave të paraqitura nga OST sh.a gradient i rritjes së kërkesës për energji elektrike në shkallë vendi mbi baza vjetore është i rendit rreth 1.8%.

Duke përdorur profilin e ngarkesës me bazë orare për ditën e mesatarizuar të cdo muaji, është bërë parashikimi i volumit të energjisë elektrike që do të transmetohet nëpërmjet rrjetit të transmetimit për vitin 2019. Në total, pritet që konsumi bruto për vitin 2019 të jetë rreth 7,300 GWh dhe pritet të mbulohet nga prodhimi vendas në masën rreth 4,700 GWh dhe importi në masën 2,600 GWh.

Për sa i përket prodhimit në vend, pritshmëritë sipas OST sh.a për vitin 2019 janë që rreth 3,300 GWh të prodhohen nga KESH sh.a dhe rreth 1,400 GWh nga PPE-të. Mbulimi i kërkesës së pritshme, është bërë në bazë të eksperiencës shumë vjecare nga OST sh.a. duke marrë në konsideratë prurjet në kaskadë me 75% siguri

**Në kapitullin e pestë** OST sh.a përshkruan funksionet dhe përgjegjësitë e Operatorit të Tregut (OT) për të cilin thotë që është pjesë e strukturës së OST sh.a. në nivel Departamenti. DOT administron Rregjistrin e Palëve të tregut si edhe ndjek procedurat përkatëse të regjistrimit të tyre mbështetur në Rregullat e Tregut (RrT) dhe Kodin e Sistemit të Transmetimit (KST).

OT është në proces ristrukturimi për një funksionim sa më të mirë në plotësimin e detyrave në lidhje me zhvillimin e TEE, në ndjekje dhe në përputhje edhe me zhvillimet rajonale dhe direktivat e Bashkimit Europian.

**Në kapitullin e gjashtë,** Shoqëria ka përshkruar në vija të përgjithshme zhvillimet në tregun e energjisë balancuese dhe humbjeve në rrjet.

Për vitin 2019, humbja e energjisë në rrjet është vlerësuar në rreth 179 GWh. Kjo sasi energjie do të blihet me bazë tregu, dhe si ç' deklarohej nga OST sh.a, bazuar në të dhënat e HUPX është konsideruar çmimi mesatar vjetor prej rreth 60 €/MWh. Fondi që kërkohet për blerjen e kësaj sasive energjie është rreth 1,400 milion lekë.

Në lidhje me prokurimin e kapacitetit rregullues dhe atij rezervë për shërbimin e balancimit, OST ka dhënë sqarime në lidhje me rregullimin sekondar, ku kërkon rreth 166 milion lekë, rregullimin terciar ku kërkon 350 milion lekë si dhe ridispeçimin ku kërkon 493 milion lekë.

**Në kapitullin e shtatë,** OST sh.a ka paraqitur llogaritjen e tarifës së transmetimit për vitin 2019 ku përfshihen kostot kapitale dhe kostot operative.

Zhvillimi i rrjetit të transmetimit në përputhje me parashikimet afatgjata dhe me planet e zhvillimit të sektorit elektroenergetik në tërësi është një nga funksionet themelore të OST dhe përbën një domosdoshmëri për kryerjen e funksioneve të saj.

Gjatë viteve të fundit janë kryer një sërë studimesh të sistemit të transmetimit që kanë përcaktuar projektet kryesore të nevojshme për zhvillimin e tij. Disa nga këto projekte janë në fazë implementimi dhe të tjerë, për të cilët është siguruar financimi nga institucione financiare ndërkombëtare do të vihen në zbatim në një periudhë kohore të përcaktuar.

Vlera e parashikuar me fondet e huaja për projektet e rendituara më sipër është e paraqitur në formë tabelare për secilin projekt në materialin e dërguar nga OST.

**Në kapitullin e tetë** OST sh.a ka paraqitur ndarjen e kostove në kosto kapaciteti dhe energjie.

Kostot e kapacitetit kanë të bëjnë kryesisht me investimet që bëhen për fuqizimin e kapacitetit transmetues të rrjetit elektrik dhe janë funksion i ngarkesës maksimale që paraqesin përdoruesit e këtij rrjeti. Të ardhurat totale të mbledhura nëpërmjet pagesave të kapacitetit për vitin 2019 janë kostot kapitale të cilave u zbriten të ardhurat nga alokimi i kapaciteteve ndërkufitare.

Duke analizuar situatën elektroenergetike për vitin 2019, OST sh.a. vlerëson se shuma e kapaciteteve totale të Konsumatorëve të Kualifikuar + OSHEE do të jetë e barabartë me 1,450 MW.

Kostot e energjisë e cila ka të bëjë me pagesën për energjinë në lekë/kWh, bazuar në sasinë e kWh të livruar nga sistemi i transmetimit tek klientët e sistemit të transmetimit.

Për sa i përket llogaritjes së tarifës mesatare të transmetimit për vitin 2019, OST sh.a. ka paraqitur në formë tabelare llogaritjet përkatëse të ndara në 3 varjante të cilat argumentohen si më poshtë:

Metodologjia e llogaritjes së tarifave të transmetimit			Viti 2019		
Pershkrimi		Njesia	Version 1	Version 2	Version 3
Nivel I synuar I te ardhurave (I+II+III)		Milion Leke	Metodologjia	Mospagesa e huave	Mospagesa e huave, Marrja e Shërbimeve ndihmëse nga KESH
C = C kapital + C operuese - Te ardhurat nga abikimi i kapaciteteve			9,952	6,835	6,035
C kapital= R+D			6,069	2,952	2,952
Kthimi mbi kapitalin (R = B*wacc)		Milion Leke	3,617	500	500
a.	B (Baza e rregulluar e aseteve)	''	47,722	47,722	47,722
b.	WACC = [ES * ARoE / (1-T)] + (DS * CoD)	%	7.58%	1.05%	1.05%
	ES - Objektiv per raportin e kapitalit te vet ne RAB	''	58.4%	58.4%	58.4%
	T - Norma e takses se korporates	''	15%	15%	15%
	ARoE - Norma e lejuar e kthimit mbi kapitalin e vet pas takse	''	9.6%	1.5%	1.5%
	DS - Objektiv per raportin e bonxhit ne RAB	''	41.6%	41.6%	41.6%
	CoD - Kosto e bonxhit	''	2.3%	0.0%	0.0%
2 Amortizimi i vitit (D)		Milion Leke	2,452	2,452	2,452
C operuese			5,083	5,083	4,283
1	Personel	''	1,380	1,380	1,380
2	Shërbime administrative e te tjera	''	620	620	620
3	Materiale të para	''	130	130	130
4	Blerja e shërbimeve ndihmëse	''	1,000	1,000	200
5	Blerja e humbjeve	''	1,400	1,400	1,400
6	Pagesë ITC (Inter TSO Compensation mechanism)	''	500	500	500
7	Pagesë për organizmat rajonale e europianë	''	50	50	50
8	Taksa	''	3	3	3
Te ardhurat nga alokimi i kapaciteteve			(1,200)	(1,200)	(1,200)
E - Energjia e transmetuar (OSHEE + te tjere)		GWh	7,158	7,158	7,158
Tarifa mesatare e transmetimit		Lek/kWh	1.39	0.95	0.84
1 $P_{mesatare} = C_{kapital} / L$		Lekë/kW/msaj	279.8	100.7	100.7
C kapital = C kapital - Te ardhurat nga Abikimi		Milion leke	4,869	1,752	1,752
L - shuma e kapacitetit total mujor		KW	1,450,000	1,450,000	1,450,000
2 $P_{mesatare} = C_{operuese} / E$		Lekë/kWh	0.71	0.71	0.80
C operuese		Milion leke	5,083	5,083	4,283
E - Energjia e transmetuar (OSHEE + te tjere)		GWh	7,158	7,158	7,158
3 $P_{mesatare} (Te ardhurat e transmetimit) = (C_{kapital} + C_{operuese}) / E$		Lek/kWh	1.39	0.95	0.84

**Varianti I** parashikon përmbushjen e të gjitha detyrimeve të OST sh.a. përgjatë vitit 2019, duke përfshirë pagesën e detyrimeve për kredi, të cilat aktualisht janë detyrim i OSHEE për t'u paguar, referuar vendimeve të ERE nr. 52, date 6.4.2017 dhe nr.190, datë 22.12.2016 të cilët përcaktojnë se OSHEE sh.a, përveç shlyerjes së detyrimeve korente, të kryejë edhe pagesat ndaj KESH sh.a dhe OST sh.a nga detyrimet e prapambetura për qëllime të pagesave të kredive nga OST sh.a dhe KESH sh.a.

Për vitin 2019 OST sh.a duhet të paguajë rreth 3,118 milion lekë në bazë të marrëveshjeve për ripagimin e kredive me Ministrinë e Financave dhe KESH. Vetëm shtesa e detyrimit për të paguar kreditë, shërbimet ndihmëse dhe ITC nga ana e OST sh.a do të kërkonte që tarifa të rritej me 0.64 Lekë/KWh.

Në përfundim tarifa e propozuar për këtë varjant arrin në **1.39 lekë/kWh**.

**Varianti II** parashikon që OST vazhdon të mos paguajë kreditë, por ndryshimi në krahasim me situatën aktuale është blerja në treg e shërbimeve ndihmëse me një vlerë prej rreth 1,000 milion lekësh në vit ndërkohë që vlera me të cilën aktualisht po i siguron ato është rreth 200 milion lekë. Shtesa në tarifë për këtë rast rezulton 0.2 Lekë/KWh.

Në përfundim tarifa e propozuar për këtë varjant arrin në **0.95 lekë/kWh**.

**Varianti III** është pothuajse i ngjashëm me situatën aktuale të OST, pra shërbimet ndihmëse sigurohen nga KESH si dhe kreditë nuk paguhen referuar vendimeve të ERE nr. 52, datë 6.4.2017 dhe nr.190, datë 22.12.2016. Shtesa prej 0.09 Lekë/kWh rezulton kryesisht si efekt i rritjes së shpenzimeve për ITC ndryshimeve në zërat e tjerë të shpenzimeve.

Në përfundim tarifa e propozuar për këtë varjant arrin në **0.84 lekë/kWh**.

## 1. OPEX

### Shpenzime personeli

- Shpenzimet analitike të personelit për periudhën Janar-Tetor 2018 si dhe parashikimi për vitin 2018 dhe 2019.

Shpenzime personeli			
Zëri	10M 2018	2018 - I Pritshëm	2019
Fondi i pagave	599,332,275	720,000,000	750,000,000
Pagesa për turne dhe orë jashtë orarit	31,173,372	38,000,000	58,000,000
Pagesa për turne	23,307,873	28,000,000	40,000,000
Pagesa për orë jashtë orarit	7,865,499	10,000,000	18,000,000
Shpenzime ushqimi për punonjësit	71,538,500	86,000,000	95,000,000
Shpenzime për udhëtime dhe dieta	42,503,450	52,000,000	60,000,000
Sigurimet shoqërore dhe shëndetsore	116,336,333	140,000,000	150,000,000
Shpenzime page për vjetërsi në punë	67,775,901	82,000,000	90,000,000
Fondi suplementar i pensionit	18,856,554	30,000,000	60,000,000
Shpenzime të tjera për personelin	50,328,889	62,000,000	65,000,000
Shpërblimi në fund të vitit	-	65,000,000	67,000,000
<b>Totali</b>	<b>997,845,273</b>	<b>1,275,000,000</b>	<b>1,395,000,000</b>
Nr. mesatar i punonjësve	755.00	755.00	761.00
Paga mesatare	79,381.76	79,470.20	82,128.78

Nga aplikimi për tarifën e transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2019, vërejmë se Shoqëria kërkon 1,395 milionë lekë shpenzime personeli për vitin 2019, nga 1,275 milionë si shpenzim i parashikur për vitin 2018, vlerë e cila paraqitet me një rritje prej 9.4%.

Mbas diskutimeve me OST sh.a. gjate seances degjimore ne lidhje me kete ze dhe informacioneve shtese te paraqitur ne vijim, gjykojmë që shpenzimet për personelin për vitin 2018 të korigjohen në zbritje në vlerën 44 milion leke e cila perfaqeson zërat e shpenzimeve për ndryshim strukture dhe largim nga puna (14 milion leke) dhe shpenzime për fondin suplementar të pensionit (30 milion leke), shpenzime të cilat gjykojmë që duhet të perballohen nga fitimi i Shoqërisë. Në përfundim shpenzimet e personelit për vitin 2018 rezultojnë në vlerën 1,231 milion leke.

Ne lidhje me shpenzimet e personelit per vitin 2019 e konsiderojme te arsyeshme te pranojme nje rritje prej 2.1% shpenzimi konform normes se inflacionit deri ne Shtator 2018 (burimi INSTAT) mbi vleren e pritshme te realizimit te ketij shpenzimi te vitit 2018. Si rezultat shpenzimet e personelit per vitin 2019 llogariten ne vleren 1,257 milion leke.

*Shpenzimet për materiale* të pritshme për vitin 2018 si dhe parashikimi për vitin 2019 evidentohen në tabelën në vazhdim:

Shpenzime materiale			
Zëri	10M2018	2018 - I Pritshëm	2019
Shpenzime materiale	31,146,661	50,000,000	80,000,000
Lëndë djegëse (Karburant)	39,810,050	50,000,000	50,000,000
<b>Totali</b>	<b>70,956,711</b>	<b>100,000,000</b>	<b>130,000,000</b>

Shpenzimet për lëndë të para dhe materiale që OST sh.a planifikon të shpenzojë për vitin 2019 arrijnë vlerën 130 milionë lekë. Megjithëse kjo shifër ka një rritje prej 30% krahasuar me shpenzimin e pritshem per vitin 2018 i cili parashikohet ne vleren 100 milioni leke, gjykojme qe vlera e parashikuar per kete shpenzim ka nje ndikim fare modest dhe per kete asye të miratohet sipas parashikimit te Shoqerise prej 130 milionë lekë.

#### *Shpenzime te tjera*

Më poshtë evidentohen shpenzime të tjera të pritshme për vitin 2018 si dhe parashikimi për vitin 2019:

Shpenzime të tjera			
Zëri	10M2018	2018 - I Pritshëm	2019
Qira	1,528,319	1,600,000	-
Mirëmbajtje dhe riparime	179,239,425	215,087,309.40	220,000,000
Mirëmbajtje dhe riparime per automjete nga te tretë	22,090,507	26,508,608.57	40,000,000
Sigurime	67,361,186	70,000,000	5,000,000
Kërkime dhe studime	10,000	12,000	1,000,000
Të tjera	93,958,961	112,750,753	100,000,000
Personel jashtë njesisë	102,078,925	122,494,710	150,000,000
Shpenzime për koncesione, patenta, liçensa dhe të ngjashme	17,810,000	18,000,000	18,000,000
Shpenzime postare dhe telekomunikimi	13,215,505	15,858,606	15,000,000
Shpenzime për shërbimet bankare	4,553,348	5,464,017	5,000,000
Taksa dhe tarifa vendore	1,702,692	2,043,230	3,000,000
Taksa e regjistrimit	1,798,416	2,158,099	2,500,000
Tatime të tjera	2,000	2,400	500,000
Shpenzime per daljen jashte perdorimit te mjeteve kryesore	19,560,540	23,472,648	60,000,000
Subvencione të dhëna	4,263,772	5,116,526	5,000,000
Shpenzime për pritje dhe përfaqësime	1,848,774	2,218,529	5,000,000
Gjoha dhe demshperblime	33,716,292	35,000,000	35,000,000
Shpenzime të tjera	4,426,667	5,312,000.00	5,000,000
<b>Totali</b>	<b>569,165,327</b>	<b>663,099,437</b>	<b>670,000,000</b>

Ne lidhje me shpenzimet per Mirembajtje, furnitura dhe shërbime, OST sh.a planifikon që për vitin 2019 të shpenzojë rreth 670 milionë lekë. Ne lidhje me kete shpenzim kemi marre ne konsiderate ato zera te cilat i sherbejne Shoqerise per te ushtruar aktivitetin e saj duke zbritur taksat, gjoha dhe demshperblime, shpenzime per daljen jashte perdorimit te mjeteve kryesore,

shpenzime pritje dhe perfaqesime dhe subvencione te dhena sic evidentuar dhe ne informacionet shtese te derguara nga Shoqeria meqenese keto zera shpenzimesh nuk i sherbejne aktivitetit te transmetimit te energjise elektrike.

Gjate vitit 2018 Shpenzimet per mirembajtje arrijne ne vleren 242 milion leke, ndersa shpenzimet per furnitura dhe sherbime 351 milion leke.

Duke ndjekur te njejtin arsyetim per vitin 2019, vlerat e parashikurara per shpenzimet per mirembajtje rezultojne 260 milion leke dhe shpenzime per furnitura dhe sherbime 299 milion leke.

#### Shpenzime per prokurimin e humbjeve ne rrjet

Nisur nga informacioni shtese ne lidhje me parashikimin e shpenzimeve per prokurimin e humbjeve per vitin 2018, ato arrijne ne vleren 1,210 milion leke. Ne lidhje me kete vlere OST sh.a. deklaroi ne seancen degjimore te dates 19.12.2018 se pritet te kete nje rritje te ketij shpenzimi ndikuar nga prokurimi per humbjet ne muajin Dhjetor 2018. Nisur nga ky fakt e pranojme vleren e parashikuar te ketij shpenzimi per vitin 2018 me 1,300 milion leke.

OST sh.a gjate vitit 2019 parashikon te shpenzoje 1,400 milionë lekë për prokurimin e humbjeve në rrjet, humbje e cila është vlerësuar me rreth 179 GWh. Nga Shoqëria OST sh.a parashikohet që kjo sasi energjie të blihet në treg me një çmim mesatar prej 60 Euro/MWh, bazuar në të dhënat e HUPX per vitin 2019. Pranojme argumentimin e paraqitur nga OST sh.a. ne lidhje me kete shpenzim prej 1,400 milion leke.

#### Shpenzimet per CBT

Në aplikimin e saj për tarifë, Shoqeria parashikon që të shpenzojë rreth 500 milionë lekë për pagesa CBT-je për vitin 2019, shumë e cila varet nga marrëdhëniet e shkëmbimit të energjisë me shtetet e tjera. Për llogaritjen e një shpenzimi të tillë OST sh.a është mbështetur edhe në trendin disavjeçar të këtyre lloj pagesave duke marrë në konsideratë dhe faktin se energjinë për mbulimin e humbjeve që do të prokurojë në treg të parregulluar dhe se rritja e cmimit të prokurimit të humbjeve influencon direkt në rritjen e pagesave për CBT.

OST sh.a. deklaroi se realizimi i pritshem per vitin 2018 i ketij shpenzimi arrin vleren 350 milion leke. Gjate seances degjimore te zhvilluar ne daten 19.12.2018, OST deklaroi se ky shpenzim mund te jete i larte dhe se rakordimi i ketij shpenzimi kryhet midis OST-ve gjate 6 mujorit te pare te vitit pasardhes. Per kete arsye pranojme parashikimin e OST sh.a. per kete shpenzim ne vleren 500 milion leke.

#### Sherbimet ndihmese

Në aplikimin për tarifën e transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2018, OST sh.a ka parashikuar një sërë shpenzimesh që lidhen me prokurimin e kapacitetit rregullues dhe atij rezervë për shërbimin e balancimit. Në total këto shpenzime, ku përfshihen kapacitetet rezervë të rregullimit dhe ridispeçerimi per vitin 2019 parashikohen ne vleren 1,000 milionë lekë. Nisur nga shpjegimet e informacioneve shtese, OST sh.a. ka paraqitur koston e sherbimeve ndihmese per 10 mujoin 2018 si ne tabelen ne vijim:



Shërbimet ndihmëse	
Zëri	Vlera
Janar	14,418,000
Shkurt	13,193,280
Mars	14,644,530
Prill	25,236,480
Maj	19,548,960
Qershor	11,943,600
Korrik	10,296,720
Gusht	13,221,600
Shtator	19,797,600
Tetor	13,061,790
<b>Totali</b>	<b>155,362,560</b>

OST sh.a. deklaron se per periudhen Janar-Tetor 2018, shpenzimi per blerjen e sherbimeve ndihmese eshte realizuar ne vleren 155 milion leke. Parashikimi i pritshem per vitin 2018 ne total eshte ne vleren rreth 186 milion leke. Shoqeria parashikon se dhe gjate vitit 2019 sherbimet ndihmese te realizohen ne te njejtat vlera me vitin 2018.

## 2. CAPEX

### Llogaritja e WACC

Për sa i përket strukturës së kapitalit të Shoqërisë, OST sh.a ka përdorur një strukturë me 41.60 % borxh dhe 58.40 % kapital të vetë. Bazuar ne raportimin me te fundit mbi pasqyren e pozicionit financiar e cila i perket 9 mujorin 2018, OST sh.a. ka nje strukture prej 57.75% kapital dhe 42.25 borxh.

Në këtë aplikim, OST sh.a ka përdorur si normë të lejueshme të kthimit mbi kapitalin normën prej 9.6% në mënyrë që të përballojë investimet e planifikuara në programin e zhvillimit ekonomik për vitin 2019 si dhe pagesat e kredive. Per vazhdimesi te vleresimimeve te meparshme, konsiderojme te arsyeshme qe kthimi i kapitalit te jete ne normen 2.4% e cila eshte e njejte me normen e miratuar e kthimit mbi kapitalit te vitit 2018. Kjo norme paraqet nje kthim mbi kapitalin prej afersisht 700 milion leke.

Per me teper OSSH ka deklaruar ne takimet e perbashketa se angazhohet te paguaje kostot e borxhit per OST sh.a. sipas nje marreveshje te perbashket, e cila do te rrise aftesine likujduese te Shoqerise.

E konsiderojme te arsyeshme kete norme kthimi mbi kapitalin dhe propozojme te aplikohet dhe per llogaritjen e WACC per vitin 2019.

Ne tabelen ne vijim paraqiten shpenzimet per interesa te cilat OST sh.a. parashikon te shlyeje gjate vitit 2019:

Nr.	Kreditori	Vlerat	Bilja					
			Distribucione		Principali		Interesa	
			Valuta	Leke	Valuta	Leke	Valuta	Leke
1	World Bank ( Nr.35710 ALB ) (Gov AD)	USD	-	-	159,148.76	17,019,869.17	38,559.96	4,149,822.00
2	World Bank ( Nr.35720 ALB ) (Gov AD)	USD	-	-	31,923.38	3,667,785.18	11,579.80	1,246,218.08
3	E.R.R.D ( Nr.5353 )	EUR	-	-	-	-	-	-
4	E.R.R.D ( Nr.5353 )	EUR	-	-	31,539.23	4,094,739.58	441.54	53,563.39
5	E.R.R.D ( Nr.56112 )	EUR	-	-	-	-	-	-
6	KfW - (BfAR) Projekt (Gov AD) - Tranche I, II	EUR	-	-	33,732.14	4,501,566.10	7,646.30	967,210.39
7	European Investment Bank ( Nr.71264 )	EUR	-	-	1,399,876.34	163,173,730.63	298,538.00	37,970,538.72
8	EIB - Njera Thermi Fierri Plant (Nr.72709)	EUR	-	-	44,896.96	5,649,720.19	11,337.50	1,426,711.00
9	IBICI - ABA E1) Rrumbullaz Nd. Fierri & V Dajeti	USD	-	-	33,524,931.20	31,860,305.90	10,408,766.08	10,085,053.45
10	IBLC - Japan (ABA-P2)	USD	-	-	1,762,121.74	1,649,185.73	511,445.50	495,519.54
11	Comau AID/98 (10 mld LIT)	EUR	-	-	83,855.14	10,532,330.82	10,481.90	1,319,042.30
12	Distr. elektrik & menaxhese - KESH, TTC 5	EUR	-	-	-	-	58,829.76	7,025,617.00
13	Stetin Grant (Gov AD) SICO	CHF	-	-	930,000.00	101,467,400.00	-	-
14	-	USD	-	-	-	-	-	-
15	Exp. Imp. Bank of Korea - No. ALB-1 (Gov AD)	EUR	-	-	834,501.70	107,530,493.93	404,776.30	50,937,049.59
16	KfW - 409 kV - Tiranë - Fierri - L&H	EUR	-	-	2,693,464.62	339,197,297.78	38,330.12	4,848,630.30
17	WB-40R70-100	USD	-	-	1,484,932.82	159,808,470.69	447,735.54	48,184,766.91
18	Artigjeronom	EUR	-	-	-	-	1,018,932.83	128,332,507.33
19	KfW - 300 kV - 10.750	EUR	-	-	-	-	80,625.00	10,143,850.00
20	KfW - 300 kV - 17.750	EUR	-	-	4,441,176.00	532,877,587.84	1,158,258.83	145,755,291.33
21	KfW - 300 kV - 20.750	EUR	-	-	-	-	10,800.00	1,238,400.00
22	KfW - 400 kV - Tiranë - Fierri - L&H	EUR	-	-	4,666,666.66	587,233,332.49	1,198,400.00	150,896,656.03
23	Efikienca energjetike programi per sektorin e energjise elektrike	EUR	13,778,064	1,983,511,510.84	-	-	275,705.00	34,695,094.72
24	1)Bekimet i Linjes se Intercambionit 400 kV Elbasan-Blloze (Matagjoni), 2)Bekimet i Ri 400kV Elbasan 3, 3)B. njeja Elbasan (Pur dhe 4) Monocamioni Fier	EUR	9,256,312	1,164,814,302.08	2,630,000.00	330,910,200.00	171,875.00	21,628,750.00
25	Investim Marjet Drenka e te Oshtrave	ALL	2,097,333,333	2,097,333,333.33	-	-	8,639,575.21	8,639,575.21
	<b>Total</b>			<b>3,160,318,819.21</b>		<b>2,448,003,168.81</b>		<b>665,058,881.98</b>

Kostoja mesatare e borxhit llogaritet nga OST sh.a në nivelin 2.3%. Llogaritja e koston se borxhit mbas analizes tone eshte kryer nisur nga shpenzimet per interesa te paraqitura ne tabelen me larte te cilat do te paguhen gjate vitit 2019 ne vleren 669 milion leke mbi huate afatgjata dhe afatshkurtra sipas pasqyres se pozicionit financiar (9 mujori 29,630 milion leke).

Ne perfundim, duke mare ne konsiderate elementet e percaktuar si me larte, rezulton nje WACC prej 2.6% per vitin 2019.

### 3. RAB (Baza e Rregulluar e Aseteve)

Ne tabelat ne vijim paraqiten baza e rregulluar e asetve sipas aplikimit per tarifen e transmetimit OST sh.a.:

Nr.	Pershkrimi	Ungjaria kontraktuale	Viti 2018			
			Kosto historike e asetve	Amortizimi vjetor	Amortizimi i akumultuar	Vlera neto e asetve
1	Software dhe licenca	205/206	618,796,794	100,249,368	257,577,665	261,221,128
2	Toka	311	2,296,608,723	4,046,007,71	12,937,973	2,284,560,800
3	Ndertesa	212	2,656,709,294	98,824,127,34	239,313,086	2,417,395,208
4	Instalime, makineri dhe pajise te tjera	213	48,562,015,377	1,970,906,290	7,187,906,664	41,374,108,623
5	Mjete transporti	215	956,428,791	35,991,016,73	142,959,345	413,569,446
6	Mobilitet, pajise zyre,pajise informatike	216	1,262,601,832	174,952,614	480,989,962	821,648,370
	<b>Total</b>		<b>57,848,162,811</b>	<b>2,351,969,474</b>	<b>8,220,920,569</b>	<b>49,722,542,825</b>

Nr.	Pershkrimi	Ungjaria kontraktuale	Viti 2019			
			Kosto historike e asetve	Amortizimi vjetor	Amortizimi i akumultuar	Vlera neto e asetve
1	Software dhe licenca	205/206	618,796,794	100,249,368	357,827,093	260,971,760
2	Toka	311	2,296,608,723	4,046,008	16,353,930	2,280,254,793
3	Ndertesa	212	2,656,709,294	65,824,127	309,128,069	2,351,581,229
4	Instalime, makineri dhe pajise te tjera	213	55,415,615,377	2,028,019,623	9,166,928,177	46,249,687,200
5	Mjete transporti	215	956,428,791	35,991,017	178,850,362	377,578,430
6	Informatike	216	2,966,001,832	217,787,614	646,741,176	2,319,260,656
	<b>Total</b>		<b>64,510,162,811</b>	<b>2,451,907,757</b>	<b>10,672,828,743</b>	<b>53,837,334,068</b>

Vlera e RAB e propozuar nga OST sh.a. per vitin 2019 arrin ne 47,722 milion leke,nderkohe qe vlersimi jone per vitin 2019 arrin ne 41,332 milion leke. Kjo diference ashtu sic dhe diskutuar gjate seancave te ndryshme me OST sh.a. vjen si pasoje e rivlersimit te asetve qe Shoqeria ka kryer gjate periudhes ushtrimore 2015. Sipas percaktimeve te Metodologjise se llogaritjes se tarifave te transmetimit te energjise elektrike, ne lidhje me llogaritjen e RAB meret ne konsiderate vlera fillestare e RAB (kosto historike e asetve) e miratuar me vendimmarrjen e vitit 2015. Ne lidhje me kete diference, ne vazhdim per periudhat e ardhshme rregullatore do te qartesohen dhe sakesohen vlerat e RAB nga ana e OST sh.a.

Permendim faktin se OST sh.a. ende nuk ka derguar per miratim ne ERE, planin e investimeve per vitin 2018 dhe per vitin 2019. Panvaresisht kesaj ne kemi marre ne konsiderate vlerat e vendosura ne llogaritjen e bazes se aseteteve si ne tabelen ne vijim:

Zerat	Realizimi 2015 sipas te dhenave te bilancit	Realizimi 2016 sipas te dhenave te bilancit	Realizimi 2017 sipas te dhenave te bilancit	Miratuara nga ERE 2018	Vlersimi I ERE mbi Realizimi i pritshem 2018 (654/2)	Aplikimi I OST per vitin 2019	ERE 2019
Vlera e aseteteve 2010	13,954	13,954	13,954	13,954	13,954		13,954
Vlera e investimeve te bera 2010	1,861	1,861	1,861	1,861	1,861		1,861
Vlera e investimeve te parashikuara 2011 (1/2)	9,957	9,957	9,957	9,957	9,957		9,957
Vlera e investimeve te parashikuara 2012 (1/2)	4,343	4,343	4,343	4,343	4,343		4,343
Vlera e investimeve te parashikuara 2013 (1/2)	1,656	1,656	1,656	1,656	1,656		1,656
Vlera e investimeve te parashikuara 2014 (1/2)	4,482	4,482	4,482	4,482	4,482		4,482
Vlera e investimeve te parashikuara 2015 (1/2)	7,650	8,746	8,746	8,746	8,746		8,746
Vlera e investimeve te parashikuara 2016 (1/2)		3,109	3,109	3,109	3,109		3,109
Vlera e investimeve te parashikuara 2017 (1/2)			914	914	914		914
Vlera e investimeve te parashikuara 2018 (1/2)				2,183	1,828		1,828
Vlera e investimeve te parashikuara 2019 (1/2)				1,085	1,240		2,479
Minus amortizimi i akumuluar deri 31.12.2011							2,613
Minus amortizimi i akumuluar deri 31.12.2012							
Minus amortizimi i akumuluar deri 31.12.2013							
Minus amortizimi i akumuluar deri 31.12.2014							
Minus amortizimi i akumuluar deri 31.12.2015	(10,290)						
Minus amortizimi i akumuluar deri 31.12.2016		(12,314)	(14,599)				
Minus amortizimi i akumuluar deri 31.12.2017				(17,020)	(16,974)		
Minus amortizimi i akumuluar deri 31.12.2018							(19,426)
Amortizimi i pritshem 2012							
Amortizimi i pritshem 2013							
Amortizimi i pritshem 2014							
Amortizimi i pritshem 2015	(1,630)						
Amortizimi i pritshem 2016							
Amortizimi i pritshem 2017		(2,024)					
Amortizimi i pritshem 2018							
Amortizimi i pritshem 2019							
Minus Grantet	(620)	(594)	(607)				(593)
<b>Vlera neto e Aseteteve</b>	<b>31,363</b>	<b>33,176</b>	<b>33,816</b>	<b>34,356</b>	<b>40,525</b>	<b>47,722</b>	<b>41,332</b>

Ne lidhje me grantet kemi zatur praktiken e ndjekur deri me tani duke e korigjuar ne zbritje kete vlere ne RAB, per arsye se Shoqeria nuk duhet te marri fitim mbi asetet e marra dhurate.

### Amortizimi

Amortizimi I paraqitur nga OST sh.a. në aplikimin për tarifë është në vlerën 2,452 milion lekë, vlerë e cila është marrë në konsideratë në llogaritjen e Bazës së Rregulluar të Aseteve (RAB) sic vërehet dhe në tabelën e mësipërme. Permendim faktin se nuk janë paraqitur llogaritjet analitike te amortizimit te cilat jane kerkuar nga ana jone gjate periudhes, por gjykojme qe periudhen ne vazhdim te qartesohet dhe sakesohet amortizimi pergjate monitorimit ne OST sh.a. Ne rastin se do te rezultojne diferenca, ato do te reflektohen ne periudhen pasardhese.

#### **4. Parashikimi i kerkeses per energji per vitin 2019**

Ashtu sikurse ne fillim te relacionit kemi paraqitur argumentat e OST sh.a. ne lidhje me situaten energjitike dhe parashikimet e sasise se energjise qe do te levrohet ne rrjetin e transmetimit per vitin 2019, sasi e cila eshte komponent i rendesishem i perlllogaritjes se aktivitetit te transmetimit te energjise elektrike.

Nisur nga diskutimet gjate seances degjimore te dates 19.12.2018, palet si OSSHEE sh.a. ne funksion te Operatorit te Sistemit te Shperndarjes dhe Furnizuesit Universal /FSHU sh.a. shprehen dakortesine e tyre per sasine e energjise se parashikur per vitin 2019.

Verejme se ky komponent eshte i axhustueshem ne periudhat pasardhese, ne rast se sasia e parashikur ndryshon nga sasia faktike e levruar per gjate periudhes ushtrimore 2019.

## 5. Tarifa e per aktivitetin e transmetimit te energjise elektrike nga OST sh.a. per vitin 2019

Zerat	Realizimi 2015 sipas te dhenave te bilancit	Realizimi 2016 sipas te dhenave te bilancit	Realizimi 2017 sipas te dhenave te bilancit	Miratuara nga ERE 2018	Vlersimi i ERE mbi Realizimi i pritshem 2018 (654/2)	Aplikimi i OST per vitin 2019	ERE 2019
Mirembajtje	203	103	138	130	242		260
Shpenzime materiale			94		100	130	130
Personeli	1,020	1,013	1,078	1,253	1,275	1,380	1,257
korrigjim shpenzime personeli					(44.0)		
Blerje energji per humbjet	231	320	229	1,165	1,300	1,400	1,400
Sherbime ndihmese	117	94	94	1,233	186	1,000	186
CBT	188	170	252	500	350	500	500
Furnitura dhe Sherbime	417	396	285	600	351	620	299
Pagese per organizmat rajonale europian taksa		19	-	90		50	50
					4	3	6
<b>Totali OPEX</b>	<b>2,176</b>	<b>2,115</b>	<b>2,169</b>	<b>4,971</b>	<b>3,764</b>	<b>5,083</b>	<b>4,088</b>
Vlera e asetëve 2010	13,954	13,954	13,954	13,954	13,954		13,954
Vlera e investimeve te bera 2010	1,861	1,861	1,861	1,861	1,861		1,861
Vlera e investimeve te parashikuara 2011 (1/2)	9,957	9,957	9,957	9,957	9,957		9,957
Vlera e investimeve te parashikuara 2012 (1/2)	4,343	4,343	4,343	4,343	4,343		4,343
Vlera e investimeve te parashikuara 2013 (1/2)	1,656	1,656	1,656	1,656	1,656		1,656
Vlera e investimeve te parashikuara 2014 (1/2)	4,482	4,482	4,482	4,482	4,482		4,482
Vlera e investimeve te parashikuara 2015 (1/2)	7,650	8,746	8,746	8,746	8,746		8,746
Vlera e investimeve te parashikuara 2016 (1/2)		3,109	3,109	3,109	9,432		9,432
Vlera e investimeve te parashikuara 2017 (1/2)			914	2,183	1,828		1,828
Vlera e investimeve te parashikuara 2018 (1/2)				1,085	1,240		2,479
Vlera e investimeve te parashikuara 2019 (1/2)							2,613
Minus amortizimi i akumuluar deri 31.12.2011							
Minus amortizimi i akumuluar deri 31.12.2012							
Minus amortizimi i akumuluar deri 31.12.2013							
Minus amortizimi i akumuluar deri 31.12.2014							
Minus amortizimi i akumuluar deri 31.12.2015	(10,290)						
Minus amortizimi i akumuluar deri 31.12.2016		(12,314)	(14,599)				
Minus amortizimi i akumuluar deri 31.12.2017				(17,020)	(16,974)		
Minus amortizimi i akumuluar deri 31.12.2018							(19,426)
Amortizimi i pritshem 2012							
Amortizimi i pritshem 2013							
Amortizimi i pritshem 2014							
Amortizimi i pritshem 2015	(1,630)						
Amortizimi i pritshem 2016							
Amortizimi i pritshem 2017		(2,024)					
Amortizimi i pritshem 2018							
Amortizimi i pritshem 2019							
Minus Grantet	(620)	(594)	(607)				(593)
<b>Vlera neto e Aseteve</b>	<b>31,363</b>	<b>33,176</b>	<b>33,816</b>	<b>34,356</b>	<b>40,525</b>	<b>47,722</b>	<b>41,332</b>
Kapitali i punes	181.31	176.28	180.75	414.25	313.69	423.58	340.69
<b>Baza e Rregulluar e Aseteve</b>	<b>31,544</b>	<b>33,353</b>	<b>33,997</b>	<b>34,770</b>	<b>40,838</b>	<b>48,146</b>	<b>41,672</b>
ARoE - Norma e lejuar e kthimit mbi kapitalin e vet pas t	3.46%	3.46%	5.48%	2.40%	2.40%	9.60%	2.40%
ES - Objektiv per raportin e kapitalit te vet ne RAB	45.97%	46.33%	58.40%	53.70%	57.75%	58.40%	57.75%
T - Norma e takses se korporates				15.00%	15.00%	15.00%	15.00%
CoD - Kosto e borxhit	3.46%	3.46%	1.50%	3.40%	3.40%	2.30%	2.30%
DS - Objektiv per raportin e borxhit ne RAB	54.02%	53.66%	41.60%	46.30%	42.25%	41.60%	42.25%
<b>WACC (Weighted Average Cost of Capital)</b>	<b>3.46%</b>	<b>3.46%</b>	<b>3.82%</b>	<b>3.09%</b>	<b>3.07%</b>	<b>7.55%</b>	<b>2.60%</b>
<b>Kthimi i lejuar mbi (RAB)</b>	<b>1,091</b>	<b>1,154</b>	<b>1,299.56</b>	<b>1,074.55</b>	<b>1,252.54</b>	<b>3,636.23</b>	<b>1,084</b>
Kompensim alokimi i kapaciteteve	(1,703)	(1,489)	(1,415)	(1,200)	(1,200)	(1,200)	(1,200)
Kompensim i te ardhurave te kerkuara		(165)	47.3				
<b>Te ardhura nga lidhjet e reja</b>							
Amortizimi i vitit	1,629	2,024	2,285	2,421	2,375	2,452	2,452
Axhustim i periudhes se meparshme							
Axhustim 2015				(1,172)	(1,172)		
Axhustim 2016				(637)	(637)		
Axhustim 2017				(31)	(118)		
Axhustim 2018							(1,047)
<b>Total i Te Ardhurave te Kerkuara</b>	<b>3,193</b>	<b>3,640</b>	<b>4,386</b>	<b>5,426</b>	<b>4,264</b>	<b>9,971</b>	<b>5,378</b>
Energjia Neto e Transmetuar	6,716	6,580	6,930	7,231	7,081	7,158	7,158
<b>Tarifa mesatare e transmetimit</b>	<b>0.48</b>	<b>0.55</b>	<b>0.63</b>	<b>0.75</b>	<b>0.6022</b>	<b>1.39</b>	<b>0.75</b>
ne te ardhurat ne tarifen e realizuar krahasuar me tarifer	(0.17)	(0.10)	(0.02)		(0.15)		
	(1,172)	(637)	(118)		(1,046.78)		

Nga te ardhurat e kerkuara te llogaritura si ne tabelen me siper, gjykojen qe te korigjohen ne zbritje, te ardhurat nga alokimi i kapaciteteve prej 1,200 milion leke e parashikuar per vitin 2019 si dhe te ardhurat e konsideruara te teperta per periudhat paraardhese prej 1,047 milion leke.

Ne perfundim ne lidhje me OPEX dhe CAPEX ne tere si, rezervojme te drejten e rishikimit te ketyre shpenzimeve ne periudhat e ardhshme kundrejt vlerave reale te tyre.

**Bazuar ne nenet 16, 19 germa "c/i" te Ligjit 43/2015 "Per Sektorin e Energjise Elektrike", Nenit 19 pika 1 germa "c" dhe nenit 22 te "Rregullores se organizimit, funksionimit dhe procedruave te ERE-s" miratuar me Vendimin e Bordit te ERE-s Nr. 96, date 17.06.2016, "Metodologjise se llogaritjes se tarifave te transmetimit te energjise elektrike", miratuar me Vendimin e Bordit te ERE-s Nr.180, date 08.11.2017, i propozojme Bordit te ERE-s:**

- **Miratimin e tarifes se sherbimit te transmetimit te energjise elektrike per vitin 2019 prej 0,75 lekë/kWh.**